

Nr 7165 prot  
10.12.2019



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI QARKU FIER

7 E-mail...  
11.12.2019

Nr. 1325/1 Prot.

Fier, më 05.12.2019

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec.

**Drejtuar:** Znj. Majlinda **BUFI**  
KRYETARE E BASHKISË ROSKOVEC

**ROSKOVEC**

**Për dijëni:** Znj. Eleni **GOGA**  
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC

**ROSKOVEC**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 6955 prot. Datë 26.11.2019, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1825 prot. Datë 02.12.2019, bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16, shqyrtuam vendimet e Këshillit Bashkiak Roskovec të miratuara në mbledhjen e datës 22.11.2019 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimet si më poshtë:

**Vendimi Nr. 101 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 tetor 2019"** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 2, neni 9, neni 24 ; Ligjin Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" neni 21; VKM-në Nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" Kreu IV pika 2 si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%" (i ndryshuar).

**Vendimi Nr. 102 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për anulim të vendimit Nr. 93 datë 23.10.2019 "Ndërtim i rrethrotullimit Qëndër Roskovec" dhe anullim të Vendimit**



**Nr.96. datë 23.10.2019 “Ndërtim i 4 lulishte në fshatin Velmish”** Është në përputhje me Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 113.

**Vendimi Nr. 103 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratim të hartës së përditësuar, të kufijve ndarës administrativo-territorial të Njësive Administrative dhe fshatrave të Bashkisë Roskovec”** Është në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 93.

**Vendimi Nr. 104 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e variantit të ndryshimit të projektit “Për rikualifikim urban dhe zhvillimin e bllokut Nr.2 Qendra e qytetit Roskovec”** Ju kthehet si i paligjshëm në bazë të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” neni 109 shkronja “a” për moskompetecë të Këshillit Bashkiak bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 12 “Përgjegjësitë e këshillit bashkiak”.

Këshilli bashkiak nuk ka kompetencë për të miratuar ndryshimet e projekteve.

Në nenin 48 pika 2 të Ligjit Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 percaktohet se “*Rishikimi i kushteve të lejes kryhet nga autoriteti që e ka miratuar lejen....*” ndërsa në pikën 3 të nenit 48 parashikohet se “*Kushtet e tjera të lejes dhe procedura e rishikimit të tyre, sipas përcaktimeve të këtij neni, kryhet sipas rregullores së zhvillimit*” Rregullorja e zhvillimit është miratuar me VKM Nr.408 datë 13.05.2015 (i ndryshuar). Bazuar në Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, datë 30.07.2015 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga Autoritetet e Zhvillimit të Territorit për Shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi deri në miratimin e Planeve të Përgjithshme Vendore”, (i ndryshuar) pika 4, ju duhet të vazhdoni procedurën me sistemin elektronik të lejeve, për ndryshim projekti dhe në mungesë të një plani të përgjithshëm vendor të miratuar, të kërkonte mendimin e AZHT, pasi për këtë projekt ju keni marrë edhe akt konformiteti nga ky organ me shkresën me Nr. 67 Prot.datë 09.01.2019 “Projekti zhvillimor i Bllokut Nr. 2”, si autoriteti kompetent për kontrollin e konformitetit të zhvillimeve të propozuara pranë Bashkive të cilat nuk kanë Plane të Përgjithshme Vendore (PPV) të miratuara, për të gjitha rastet përjashtimore.





Bazuar në Ligjin 109/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” (i ndryshuar) neni 52 “Kryerja e ndryshimeve në projekt apo e punimeve, në kushtet e lejes përbën kundërvajtje administrative”.

Për sa i përket pikës 2 të vendimit “Autorizimin e bashkisë Roskovec për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit pas plotësimit të kushtit të kërkuarit për financimin e pjesës së kubaturës së përcaktuar në projekt dhe pjesën rrethuese të kësaj kubature me nje rrjedhë uji dhe kushtit për heqjen dorë nga proceset gjyqësore civile dhe penale përveç proceseve të kundërshtimit të vlerës së shpronësimit” Ju kthehet si kundërshtim më Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e këshillit” dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë nenet 17 dhe 18. Dhënia e autorizimit nga ana e këshillit kryetarit të bashkisë për lidhjen e një marrëveshje bashkëpunimi në të ardhmen, me kusht për heqjen dorë të kërkuarit nga proceset gjyqësore është i pabazuar ligjërisht. E drejta që ka cdo person për tju drejtuar organeve kompetente për të kërkuar të drejtën e tij është një e drejtë e garantuar me ligj.

*Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.(neni 18 i Kushtetutës). Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (neni 17 i Kushtetutës).*

*Për sa i përket hyrjes në fuqi të vendimit Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 55 pika 6 parashikon se aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë ne fuqi 10 ditë pas shpalljes.*

Këshilli bashkiak për sa i përket hyrjes në fuqi të vendimeve duhet ti referohet ligjit dhe vetëm ligjit.

**Vendimi Nr. 105 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2020”** Është në përputhje me Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.3, neni 35, neni 54 gërma “f”; Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) nenet 9-32 si dhe në zbatim të Ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

SEKRETARIA  
TË QARKUT

**Vendimi Nr. 106 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për miratimin e procesit zgjedhor të përfunduar, për zgjedhjen e anëtarëve të Kryesive dhe Kryetarëve të fshatrave nën juridiksionin territorial të Bashkisë Roskovec”** Ju kthehet jo në përputhje me nenin 70 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Sipas pikës 5 të këtij neni ku Ju jeni mbështetur, përcaktohet se këshilli bashkiak ka vetëm detyrimin e mbikëqyrjes së procesit dhe veprimtarisë së kryesisë. Sipas këtij neni kryetari i fshatit zgjidhet nga antarët e kryesisë së fshatit ndërsa kjo e fundit (kryesia e fshatit) zgjidhet me votim, në mbledhje të fshatit, ku marrin pjesë jo më pak se gjysma e banorëve me të drejtë vote.

**Vendimi Nr. 107 Datë 22.11.2019 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për shpronësimin e fondit pyjor privat të ndodhur në fshatin Luar”** Ju kthehet në kundërshtim me ligjin Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publike” Neni 10 pika 1.

Në përmbajtjen e vendimit të miratuar nga ana Juaj mungon:

1. Përcaktimi në vendim i vlerësimit paraprak të pasurisë objekt shpronësimi si dhe i masës së shpërblimit që parashikohet për secilin pronar privat.
2. Përcaktimi në vendim i listës së pronarëve të pasurive pronë private për të cilat kërkohet shpronësimi si dhe lista e personave të tretë që duhet të kompensohen për të drejtat e tyre mbi pasuritë pronë private që kërkohet të shpronësohen (nëse ka), së bashku me shpjegimet dhe të dhënat e nevojshme për secilin prej tyre.
3. Përcaktimi në vendim i burimit dhe garantimi i fondeve financiare të nevojshme për efektet financiare që rrjedhin nga vendimmarrja.

**Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,**

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
PREFEKTI  
Baki BALA

